



Bashkia Rrogozhine

NJËSIA E PROKURIMIT

PROCES VERBAL

PËR

**ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Tipi i kontratës – PUNË

OBJEKTI I PROKURIMIT: *“Permiresimi I Banesave Ekzistuese per komunitetet e varfera e te pafavorizuara”*

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV):**
45214100-1 - Punime ndërtimi

.Ref-18921-09-12-2024

VLERA E FONDIT LIMIT: 25 725 833 (njetete e pese milione e shtateqinde e njetete e pesemije e teteqinde e tridhjte e tre) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kavajë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë::

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - a. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1*
 - b. *Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2*
 - c. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3*
 - d. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8*

Argumentimi:Njesia e Prokurimit për pikat a. dhe b.bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, seksioni III, neni 39, pika 7, gërma “ç”. Kërkesa për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 30, pika 1.Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin



Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, operatorët ekonomik duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuar të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021,2022,2023), të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar.

Shënim: Akt ekspertiza e ekspertit kontabël të autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor , organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë referuar nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik. Kërkesa për paraqitjen e xhiros së viteve financiare 2018, 2019, 2020, nuk i kufizon operatorët ekonomik vetëm në vite që mund të jenë jo të sukseshme financiarisht, por me kohështirje tre vjecare. Vlera e xhiros së kërkuar në masë jo më e vogël se vlera e fondit limit shkon përshat me vlerën e fondit limit dhe afatin e realizimit të kontratës. Konkretisht niveli i aktivitetit të shoqërisë është në masë financiare ekuivalent me vlerën e mundshme të kontratës objekt prokurimi.

2.2.2 Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023,) të lëshuar nga autoritetet përkatëse, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i



viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 43 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenit 41, pika “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”

2.2.3 Vërtetim të shlyerjes së taksave e tarifave vendore të parashkikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 dhe taksat e 2024 për sa i takon referuar Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazes së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së. Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para lidhjes së marrëveshjes kuadër

2.3 Kapaciteti Teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvoja e sukseshme në realizimin e të paktën:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **45%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se dyfishi** i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1 /a plotësohet nga anëtari , i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtar të një bashkimi, kanë të njejtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.



Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9;
 - Kontratë sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit; **(në rastet kur ky dokument lëshohet).**
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.

Shënim; Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomike duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
 - Kontratë sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit; **(në rastet kur ky dokument lëshohet).**
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.
 - Fatura tatimore të situacionit përfundimtar.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posacme te deklaruar në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- a) Kontratë bazë ndërmjet kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
- b) Miratimin zyrtar si nënkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet referuar nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik

2.4 Licensa Profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës , të leshuar nga autoritetet kompetente shtetërore;

Operatori ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP 1 – A (punime gërmimi në tokë)



- NP 3 – A (Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale , veshje fasada)
- NP 7 – A (ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje)
- N.S – 2 – A (impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)
- N.S – 4 – A (punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)
- N.S – 12 – A (impiante teknologjike, termike, dhe të kondicionimit);
- N.S – 14 – A (impiante të brendshme elektrike , telefonike, radiotelefoni tv).
- N.S -18 -A (punime topogjeodezike)

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjes për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet te plotësojnë kërkesat e licensave profesionale qe disponojne të lëshuara nga vendi i orgjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit , pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korrespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

NP 1 – A Punime gërmimi në tokë “Gërmim dheu themele me makineri” sipas preventivit bashkangjitur Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke

NP 3 – A (Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale , veshje fasada) sipas preventivit bashkangjitur Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke

NP 7 – A (ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje) sistemi hidraulik tek ambientet teknike sipas preventivit të bashkangjitur Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pishëm, ujësjellsat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke

N.S – 2 – A (impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre) Elektroshtepiake, Lavatriçe thjeshte Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e



përgjithëshme. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke

N.S – 4 – A (punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese) riparim mbulese catie m² ,riparim tavanesh dritare alumini tek xham. Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke

N.S – 12 – A (impiante teknologjike, termike, dhe të kondicionimit); Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke

N.S – 14 – A (impiante të brendshme elektrike , telefonike, radiotelefoni tv). Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke

N.S -18 -A (punime topogjeodezike) Konsiderohet zbatimi i rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh. Në këtë projekt përfshihen shumica e punimeve kerkojne ekspertizen profesionale te topografise. Nga fillimi i punimeve dhe deri ne perfundim topografia ka rendesi ne kete projekt, pasi ka sasi te konsiderueshme germimesh, rievime, sheshime etj. Topogjeodezia së bashku me Sistemet e Informacionit Gjeografik janë baza e planifikimit të territorit. Organizimi i shërbimeve përkatesë për studiot e planifikimit urban, standartizimi i plotë i tyre në përputhje me kërkesat e planifikimit, bën të mundur krijimin e të dhënave gjeohapësinore, klasifikimin dhe interpretimin e tyre të saktë si dhe sjelljen në ndërtimin e skenarëve planifikues. Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke

2.4.1 Operatori ekonomikë duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm



gjatë gjithë kohës që do të kryen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojës 8. Operatori fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune e vleshme , diplome
(Drejtuesit Teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi.)

2.4.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periushën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave , drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM-së Nr.42, datë 16.01.2008, i ndryshuar. Njëri prej drejtuesve teknik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë për auditues energjistik në ndërtesa, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë, konkretisht:

- 1(një) inxhinier Ndërtimi (drejtues Teknik) profili strukture;
- 1 (një) Inxhinier Mekanik;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi;
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik.
- 1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet/ Markshajder;

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojës 8. Operatori fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Për secilin anëtar të stafit Teknik të mësipërm duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme;
- Diplomë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e punimeve. . Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht gjithashtu edhe me kërkesat e përcaktuara në pikën **2.4.1** të kriterëve teknike. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

2.4.3 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues Teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me



kontratë pune të vlefshme , diplome përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimum për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave , konkretisht:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 ‘Per miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”’, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme , Diplomë/certifikatë e cila të jetë e leshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur në Republikën e Shqipërisë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.*

- 1 (një) punonjës I pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e leshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur në Republikën e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme,diplome/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”).* “Mjekun e shoqërisë”, e vërtetuar kjo me Kontrate pune te vlefshme brenda periudhes se realizimit te kontrates, diploma, license ushtrim profesioni

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar të paktën 4 (katër) punonjës specialist të certifikur dhe trajnuar për Punimet në lartësi sipas VKM-së nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” të jetë e leshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojës 8. Operatori fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Për secilin pjestar të stafit Teknik të mësipërm duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme;
- Diplomë;
- Certifikatën e kualifikimit.

Argumentim : VKM-të për shëndetin në punë, përcaktojnë se të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht llojit të aktivitetit dhe numrit të punëmarrësve duhet të paise me mjek ndërmarrje. Këto VKM përcaktojnë se në bazë të numrit të punëmarrësve , kohën e punës së mjekut të ndërmarrjes, i cili mund të jetë me kohë të plotë, kohë të pjeshme apo ndërsbjektor. Gjithashtu në këto VKM përcaktohet periodiciteti i kryerjes së kontrollit periodik mjekësor në varësi të llojit të aktivitetit të subjektit dhe lloji i testeve ekzaminuese mjekësore në varësi të pozicionit të punës së punëmarrësit. Lista e sëmundjeve profesionale përcakton sëmundjen profesionale që lidhet direkt me profesionin e pacientit dhe ekspozimin në vendin dhe procesin e punës.VKM-të për Shëndetin në Punë VKM Nr. 639, datë



7.9.2016 “Për përcaktimin e rregullave, të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”.

1. Për të siguruar kontrollin shëndetësor në punë të punëmarrësve, punëdhënësi:
1. punëson punëmarrësit e tij bazuar në raportin e lëshuar nga komisioni mjekoligjor pranë çdo qendre shëndetësore, i cili dorëzohet vetëm në momentin e fillimit të punës;
2. kërkon kontroll paraprak shëndetësor në momentin e punësimit dhe/ose gjatë tremujorit të parë të punës nga mjeku i punës, për të siguruar që shëndeti i punëmarrësve nuk vihet në rrezik nga ekspozimi ndaj risqeve profesionale;

1. kërkon ekzaminime të rregullta dhe periodike mjekësore për punëmarrësit, të përshtatshme sipas ekspozimit ndaj faktorëve specifikë të riskut në vendin e punës. Vizita mjekësore profesionale periodike në punë kryhet për punëmarrësit me risk të ekspozimit ndaj risqeve specifike për mjedisin e punës, si: agjentëve fizikë, kimikë, biologjikë, mutagjenë/-kancerogjenë etj., të përcaktuar në shtojcën II të këtij vendimi:
2. të paktën çdo 1 (një) vit për ndërmarrjet e grupeve A dhe B;

2.4.4 Një punësim mesatar i të paktën 45 (dyzet e pesë) personave , të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Vërtetit të lëshuar nga administrata tatimore për periudhën e fundit të deklaruar;
- Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr.629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, sic përcaktohet në tabelën bashkelidhur

2.4.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome/deshmi përkatëse lëshuar nga institucionet e akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional , si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave , si më poshtë:

- 2 (dy) punonjës teknik ndërtimi
- 3(tre) punonjës elektrikistë
- 3(tre) punonjës hidraulikë
- 3(tre) karpentier
- 1(një) mekanik



- 3 (tre) suvaxhi
- 3(tre) punonjës bojaxhi
- 2 (dy) punonjës saldatorë
- 2(dy)punonjës hidrizolues
- 3(tre) punonjës pllakashtrues
- 3(tre) punonjës muratorë.

Shënim: Për pikat 2.4.2/2.4.3/2.4.5 mësipër , Operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

Formularin e vetdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim; Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i parë duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetdeklarimit në formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr.629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, sic percaktohet ne tabelen bashkelidhur

2.5 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licence profesionale nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) kodi III.2.B Grumbullim transportim i mbetjeve urbane dhe inerte.

Argument. Kërkesa e mësipërme është hartuar në përputhje me ligjin Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, ligjit 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, VKM 538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregulla të tjera nënligjre të përbashkëta”, VKM 229 date 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme”.

2.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku zë deklarohet se, brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura , me vlerë të përbashkët ose të veçantë , jo më të madhe sr 100% i kufirit maksimal , që disponon kandidati, sipas liçencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm , fjala “periudhë” , nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

Argumentimi: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor për disponueshmërinë apo furnizimin me materialet kryesore që nevojiten për realizimin e punimeve objekt i kontratës



2.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **“Planin e sigurisë në kantier”** për punimet në objekt në formatin sipas VKM-së nr.692, datë 13.12.2001 **“Për masat e veçanta të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë”**, të ndryshuar.

Argumentimi: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor për disponueshmërinë apo furnizimin me materialet kryesore që nevojiten për realizimin e punimeve objekt i kontratës

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë , mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>MJETET</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës ≥ 10 ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç 5-8 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Dumper,për,transportin,e materialeve brenda kantierit	1 copë	Pronësi ose me qera
Elektrosaldatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere kantieri jo më pak se 2.5 m ³	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere kantieri 0.5 m ³	3 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator thellësie	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë (kapaciteti mbajtës deri në 3.5 ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Skela metalike (formë H) të kompletuara me parapet mbrojtës , shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë)	1000 m ²	Pronësi ose me qera
Pompë suvatimi	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrom me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m ³	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera



Pompë uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Depozita uji 10.000 litër	1 copë	Pronësi ose me qera

- Kokore minimumi 45 copë;
 - Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 30 copë;
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 10 copë;
 - Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë.
- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit:
- çertifikatën e pronësisë,
 - leja e qarkullimit,
 - çertifikatën e kontrollit teknik,
 - siguracionin,
 - leja e transportit e vlefshme dhe fotot përkatëse.
- b) Ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- d) Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së, duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimeve në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.



Autoriteti/ enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njejtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike., sjellim në vëmendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve / pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8) gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/ enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve , mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht për s'kualifikim.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht për s'kualifikim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën. Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr.629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre“
Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ju lutemi sigurohuni që:

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**
- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.**
- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**
- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.



- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
 - *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*
-